



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, në seancën e 50-të, të mbajtur më datë 21.07.2021 morri,

#### VENDIM

Denoncimi me numër 12-4487/1 e dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nga parashtrues i njohur- /// nga Shkupi dhe /// nga Shkupi më 27.09.2019, në bazë të të cilit është formuar lënda me numër 12- 4487/1 të datës 27.09.2019, REFUZOHET.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vlerësoi se në denoncim nuk tregohen pohime mbi të cilën ka kompetencë të veprojë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, për arsye se i njëjti denoncim të bashkangjitur me dëshmi janë dorëzuar për veprim kompetent deri te ministria e linjës.

Lënda me numër 12-4487/1 të datës 27.09.2019 në KSHPK të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri te parashtruesit e denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-4487/1 e datës 27.09.2019 e formuar në bazë të denoncimit me numër 12-4487/1 dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nga parashtrues të njohur- /// nga Shkupi dhe /// nga Shkupi.

Në lëndë jan nxjerrë pohime për shkelje të të drejtave ligjore të parashtruesve të denoncimit gjatë përgatitjes së Propozimit për PDU /// për KK ///. Sipas pohimeve në denoncim, parashtruesit në vitin 2016 paraqitën kërkesë për blerjen e tokës që ishte në pronësi të tyre që nga viti 1957 dhe në posedim të paraardhësve të tyre. Kur PDU /// ishte ekspozuar për shqyrtim publik në vitin 2017, parashtruesit zbuluan se një pjesë e parcelës me sipërfaqe 40-50m2, në të cilën boshti i tyre me ujë është e vendosur, është shkruar si pjesë e parcelës së fqinjit të tyre.

Parashtruesit u drejtuan me kundërshtim deri te Komuna ///, pas së cilës në vitin 2018 u siguruan prova se pjesa e kontestuar ishte kthyer në gjendjen e saj origjinale, si pjes e parcelës së tyre. Sidoqoftë, parashtruesit

kërkuan inspektim edhe nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, pas së cilës ata zbuluan se zona e diskutueshme ishte konfiskuar dhe e destinuar për zonë publike. Sipas kundërshtimit në Komunë /// nga viti 2019, ishin informuar se plani i ishte dërguar Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve për miratim, për shkak të së cilës për momentin nuk ishin të mundshme ndërhyrje në vendimin e planifikimit. Pas kundërshtimit në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve në të njëjtën periudhë, Ministria i dërgoi shkres Komunës /// duke informuar komunën për kompetencat e saj në lidhje me procedurat që lidhen me planet urbanistike, sondazhet publike dhe prezantimet dhe vendimmarrjen mbi listat anketuese.

Parashtruesit e denoncimit pohojn se ndarja e zonës së kontestuar për arsye të ndrihimit në hapësirë publike është e papërshtatshme dhe jologjike, dhe tregojnë se ata i janë drejtuar disa institucioneve kompetente me kërkesë për të mos ndryshuar PDU -in ekzistues për shkak të rrethanave të përshkruara.

Gjatë shqyrtimit të ratit të lëndës, KSHPK i mori parasysh pohimet dhe inspektoi dokumentacionin e bashkangjitur në denoncim, i cili përmban: kopje të listës anketuese të anketimit publik sipas projekt -planit të detajuar urbanistik, kopje të kërkesave për informacion dhe përgjigje për / nga Komuna /// dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, si dhe kopje të kundërshtimeve drejtuar të dy institucioneve.

Duke pasur parasysh se detajet nga denoncimi dhe dokumentacioni i bashkangjitur nuk i referohen pohimeve se Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka kompetencë të veprjë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin të Korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij Vendimi.

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së

E bere nga: A.R.M.

E miratuar nga: K.N, anëtar i KSHPK - së

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**

**Kryetar  
Biljana Ivanovska**